

**VENDIM**  
**Nr.1063, datë 15.12.2010**

**PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT, NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË DOKTORATËS, NË UNIVERSITETIN E TIRANËS, UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS, UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË TIRANËS, QENDRËN E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE, UNIVERSITETIN “ALEKSANDËR MOISIU” TË DURRËSIT, UNIVERSITETIN “ISMAIL QEMALI” TË VLORËS DHE AKADEMINË E MBROJTJES “SPIRO MOISIU”, NË VITIN AKADEMIK 2010-2011**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e kuotës së pranimit, gjithsej, 1266, në programet e studimeve të doktoratës, në Universitetin e Tiranës, Universitetin Politeknik të Tiranës, Universitetin Bujqësor të Tiranës, Qendrën e Studimeve Albanologjike, universitetin “Aleksandër Moisiu” të Durrësit, universitetin “Ismail Qemali” të Vlorës dhe Akademinë e Mbrojtjes “Spiro Moisiu”, në vitin akademik 2010-2011.

2. Kuota e pranimit, e përmendur në pikën 1, e ndarë sipas institucioneve publike të arsimit të lartë dhe programeve të studimeve të doktoratës, paraqitet në tabelën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Në kuotën e çdo programi studimi të doktoratës, 10% caktohet për kandidatët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë.

4. Tarifa e shkollimit, për çdo program të studimeve të doktoratës në institucionet publike të arsimit të lartë civil, si dhe për doktorantët nga jashtë Forcave të Armatosura në programet e studimeve të doktoratës në Akademinë e Mbrojtjes “Spiro Moisiu”, është 204 600 (dyqind e katër mijë e gjashtëqind) lekë, e cila paguhet në këste, të përcaktuara nga institucioni përkatës i arsimit të lartë.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i secilit institucion publik i arsimit të lartë, pa efekte buxhetore shtesë.

6. Rishpërndarja e kuotave të paplotësuara bëhet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Universiteti i Tiranës, Universiteti Politeknik i Tiranës, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Qendra e Studimeve Albanologjike, universiteti “Aleksandër Moisiu” i Durrësit, universiteti “Ismail Qemali” i Vlorës dhe Akademia e Mbrojtjes “Spiro Moisiu” për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**